

UDHËZIM
Nr. 11, datë 20.5.2022

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 10, DATË 20.4.2022, “PËR
PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS, LLOJIT DHE MËNYRËS PËR DHËNIEN E
SHËRBIMEVE *ONLINE* TË SHËRBIMIT GJEOLOGJIK SHQIPTAR”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 111/2015, “Për shërbimin gjeologjik shqiptar”, të vendimit nr. 111, datë 2.3.2022 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, si dhe në përputhje me urdhrin e Kryeministrit, nr. 153 prot., datë 25.11.2019, “Për marrjen e masave dhe rregullimin e dispozitave ligjore për aplikimin e shërbimeve vetëm *online* nga data 1.1.2020”,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 10, datë 20.4.2022, “Për përcaktimin e procedurës, llojit dhe mënyrës për dhënie të shërbimeve *online* të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Shkronjat “c” dhe “ç” të pikës 5, ndryshojnë dhe bëhen si më poshtë vijon:

a) “c. Pas plotësimit të formularit elektronik me të dhënat e nevojshme të kërkuara, bëhet konfirmimi i pagesës.”;

b) “ç. Kërkuesi brenda 30 ditë pune, nga konfirmimi i pagesës, njoftohet në seksionin “Dokumentet e mia”, në portalin *e-Albania*, për shërbimin e kërkuar.”.

2. Ngarkohet Shërbimi Gjeologjik Shqiptar për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**